

Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Infermierisë, NJVKSH Gjirokastër dhe studentë të degëve të ndryshme, organizoi një aktivitet informues, edukues dhe promociional mbi rëndësinë e shëndetit dhe kujdesit shëndetësor.

Ky aktivitet pati për qëllim ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin mbi rëndësinë e ruajtjes së shëndetit fizik, mendor dhe emocional, si dhe promovimin e stilit të jetesës së shëndetshme.

Gjithashtu, pjesëmarrësit patën mundësinë të informohen mbi tema të ndryshme që lidhen me mirëqenien dhe parandalimin e sëmundjeve, përmes bashkëbisedimeve me profesionistë të shëndetësisë.

